N'KUVEND: PËR ALTERNATIVAT MJEDISORE TË ZHVILLIMIT

QENDRA BURIMORE E MJEDISIT NË SHQIPËRI (REC ALBANIA)



**Ku është zbatuar projekti**
Shkodër, Durrës, Pogradec, Vlorë

**Kohëzgjatja**
15 muaj

**Buxheti total**
46,195 Euro



---

## OBJEKTIVAT E PROJEKTIT

**Objektivi I Përgjithshëm**

Mbështetje për të rritur diskursin e diskutimit publik të alternativave mjedisore në fokusin e zhvillimit të vendit, prej vektorëve lokalë të shoqërisë civile, përmes fuqizimit me anë të informimit, edukimit dhe advokimit.

**Objektivat Specifik**

OS.1: Rritje e presionit publik për forcimin e goditjes së ligjit ndaj krimit mjedisor përmes njohjes së kuadrit ligjor dhe raportimit të rasteve të krimit mjedisor;
OS.2: Ndikimi integrues në proceset kombëtare dhe vendore për drejtësinë mjedisore përmes forcimit të zërit të grupeve vulnerabël dhe të margjinalizuara, aksesin në burimet dhe shërbimet mjedisore;
OS.3: Integrim dhe zhvillim cilësor i edukimit mjedisor në sistemin arsimor dhe komunitet, përmes ndryshimit drejt sjelljeve pro mjedisore dhe rritjes së aktivizmit rinor në diskutimin e çështjeve mjedisore të vendit;
OS 4: Përfshirja e mjedisit në debatin publik kombëtar dhe lokal si shprehje e rritjes së aktivizmit komunitar përmes informimit aktiv dhe përfshirjes në procese vendimmarrëse.

**Grupet e Interesit**

OSHC-të mjedisore, OSHC-të që përfaqësojnë interesat e grupeve të tjera të komunitetit, si të rinisë, grave dhe medias.

**Përfituesit përfundimtar**

OSHC-të mjedisore në nivel vendor dhe kombëtar

## REZULTATET E PRITSHME

R1. Diskutimi në nivel qendror i çështjeve të rëndësishme për Zhvillimin e Qëndrueshëm të vendit, mirë-funksionimin e demokracisë dhe respektimin e të drejtave të njeriut.

R2. Katër rajone ngrenë mjetëzimet e OSHC-ve dhe kualifikohen për diskutimin kombëtar me fokus krimi mjedisor dhe zbatueshmëria e ligjit, edukimi mjedisor i publikut dhe pjesëmarrja më aktive e komunitetit në çështjet mjedisore.

R3. Tre tematika me interes të lartë në diskursin publik, do të rriten nga diskutime vendore në vlerësime kombëtare dhe pozicionime të shoqërisë civile me propozime për alternativa zhvillimi dhe fuqizimit institucional.

## AKTIVITETET KRYESORE

- Takim rajonal i OSHC-ve të rajonit jugor;
- Trajnim nga BIRN Albania mbi gazetarinë investigative;
- Trajnim nga REC Albania mbi raportimin e krimit mjedisor;
- Takim rajonal i OSHC-ve të grave/ rajoni lindor; Trajnim nga Unë Gruaja mbi dimensionin gjinor në menaxhimi e burimeve;
- Trajnim nga REC mbi pjesëmarrjen publike në Planet e Menaxhimit të Baseneve Ujëmbledhës; Takim rajonal i OSHC-ve rinore / rajoni qendror; Trajnim nga "Udhëtim i lirë" mbi aktivizmin rinor; Trajnim nga REC Albania mbi Edukim Mjedisor; Takim rajonal i OSHC-ve komunitare/ rajoni verior; Trajnim nga REC Albania mbi Ndryshimet Klimatike; Diskutim Kombëtar mbi rolin e institucioneve në adresimin e Krimit Mjedisor;
- Letër pozicioni mbi ndryshimet ligjore dhe institucionale dhe forcimi i bashkëpunimit me OSHC-të;
- Diskutim Kombëtar mbi rolin e OSHC-ve në Edukimin e Zhvillimit të Qendrueshëm të standardizuar dhe cilësor;
- Diskutim Kombëtar mbi rolin e OSHC-ve në përfshirjen e dimensionit gjinor dhe social në ndërhyrjet/programet mjedisore;
- Letër pozicioni mbi kontributin e OSHC-ve në drejtësinë mjedisore.

## MBI GREEN-AL

Projekti "Fuqizimi i Organizatave të Shoqërisë Civile për Mbrojtjen e Mjedisit në Shqipëri" zbatohet nga Co-PLAN, Instituti për Zhvillimin e Habitatit; në bashkëpunim me CISP, Comitato Internazionale per lo Sviluppo dei popoli; VIS, Volontariato Internazionale per lo Sviluppo; COSV, Coordinamento delle Organizzazioni per il Servizio Volontario me mbështetjen financiare të Agjencisë Ndërkombëtare Suedeze për Bashkëpunim dhe Zhvillim (SIDA).

Projekti synon të kontribuojë në përmirësimin dhe faktorizimin e OSHC-ve mjedisore, për të adresuar në mënyrë efektive sfidat mjedisore në vend. Fokus të veçantë, projekti i jep forcimit të

kapaciteteve të OSHC-ve dhe krijimin e mundësive të reja për bashkëpunim ndërmjet tyre, komunitetit, autoriteteve publike dhe sektorit privat.

Projekti Green-AL ka ofruar ndihmë financiare në formën e granteve për të mbështetur OSHC-të mjedisore në vend për të ngritur dhe adresuar problematika mjedisore por edhe për tu rrjetëzuar e advokuar në mënyrë të unifikuar për politika mjedisore më të mira. Skema e granteve është organizuar në 3 paketa: 1) Grantet e Iniciativës; 2) Grantet e Partneritetit; 3) Grantet e Rrjetëzimit, Advokimit dhe Ndikimit në Politikbërje.

# FUQIZIMI I ZËRIT TË SHOQËRISË CIVILE DHE KOMUNITETIT PËR NJË MJEDIS MË TË SHËNDETSHËM NË PATOS DHE MARINËZ



## ECO-PARTNERS FOR SUSTAINABLE DEVELOPMENT



**Ku është zbatuar projekti**
Bashkia Patos dhe Roskovec (Fshati Marinëz)

**Kohëzgjatja**
15 muaj

**Buxheti total**
40.000 Euro

---

## OBJEKTIVAT E PROJEKTIT

**Objektivi i Përgjithshëm**

Shoqëria civile dhe komunitetet në Patos-Marinëz të fuqizuar nëpërmjet aktiviteteve të ndërgjegjësimit, nxitjes së dialogut dhe bashkëpunimit konstruktiv në funksion të mirë-qeverisjes mjedisore të industrive nxjerrëse si garanci për rrugëtimin e Shqipërise për në BE.

**Objektivi Specifik**

Problemet e komuniteteve vulnerabël të territoreve naftënxjerrëse në Patos-Marinëz, bëhen një fakt presioni ndaj pushtetit vendor dhe impaktojnë në rehabilitimin mjedisor të munguar në territoret e industrisë naftënxjerrëse në Shqipëri.

**Grupet e interesit**

Qytetarët dhe komunitetet rurale, përfaqësuesit e bashkive të Patosit dhe Roskovecit, organizata lokale mjedisore dhe sociale të shoqërisë civile.

**Përfituesit përfundimtarë**

Komunitetet rurale dhe qytetarët e Patos – Marinzës (rreth 10,000 banorë në bashkitë Patos dhe Roskovec)

## REZULTATET E PRITSHME

R1. Rreth 1400 aktorë lokalë, përfaqësues të komuniteteve urbane e rurale dhe grupeve vulnerabël me ndihmën e 6 shoqatave dhe 6 shkollave të Bashkisë Patos dhe Roskovec (Fshati Marinëz) të ndergjegjësuar dhe fuqizuar mbi rolin e tyre si faktor presioni për një mirëqeverisje më të përgjegjshme mjedisore.

R2. Situata mjedisore në zonat naftënxjerrëse e ilustruar me matje aboratorike të ajrit, ujit dhe tokës në shërbim të komunitetit për të përmirësuar transparencën dhe llogaridhënien mjedisore në Patos dhe Marinëz.

R3. Dialog gjithëpërfshirës i facilituar dhe rekomandime konkrete nga shoqëria civile mbi rolin e pushtetit lokal në rehabilitimin mjedisor për një mirëqeverisje mjedisore më të përgjegjshme të industrisë nxjerrëse në nivel lokal.

## AKTIVITETET KRYESORE

- Vlerësim i situatës sociale në Patos-Marinëz: Organizimi i një pune hulumtuese dhe ndërgjegjësuese me shoqërinë civile lokale, komunitetin dhe grupet vulnerabël në territorin e Bashkive te Patosti dhe Roskovecit.
- Vlerësim i situatës mjedisore në Patos-Marinëz: Vlerësimi i gjëndjes së mjedisit nëpërmjet bashkëpunimit me universitetin Bujqësor të Tiranës dhe Universitetin Polis.
- Realizimi i fushatave te ndërgjegjësimit e gjelbërimit me aktorë lokalë për përmirësimin e situatës mjedisore në territoret e Bashkive Patos dhe Roskovec.
- Organizimi i një procesi dialogu në nivel lokal mbi rolin e pushtetit vendor në llogaridhënien dhe rehabilitimin mjedisor nga industria nxjerrëse e naftës dhe politikat në nivel lokal, dhe rekomandimet për rehabilitimin mjedisor nga industria nxjerrëse për pushtetin qendror.

## MBI GREEN-AL

Projekti "Fuqizimi i Organizatave të Shoqërisë Civile për Mbrojtjen e Mjedisit në Shqipëri" zbatohet nga Co-PLAN, Instituti për Zhvillimin e Habitatit; në bashkëpunim me CISP, Comitato Internazionale per lo Sviluppo dei Popoli; VIS, Volontariato Internazionale per lo Sviluppo; COSV, Coordinamento delle Organizzazioni per il Servizio Volontario me mbështetjen financiare të Agjencisë Ndërkombëtare Suedeze për Bashkëpunim dhe Zhvillim (SIDA).

Projekti synon të kontribuojë në përmirësimin dhe faktorizimin e OSHC-ve mjedisore, për të adresuar në mënyrë efektive sfidat mjedisore në vend. Fokus të veçantë, projekti i jep forcimit të kapaciteteve të OSHC-ve dhe krijimin e mundësive të reja për bashkëpunim ndërmjet tyre, komunitetit, autoriteteve publike dhe sektorit privat.

Projekti Green-AL ka ofruar ndihmë financiare në formën e granteve për të mbështetur OSHC-të mjedisore në vend për të ngritur dhe adresuar problematika mjedisore por edhe për tu rrjetëzuar e advokuar në mënyrë të unifikuar për politika mjedisore më të mira. Skema e granteve është organizuar në 3 paketa: 1) Grantet e Iniciativës; 2) Grantet e Partneritetit; 3) Grantet e Rrjetëzimit, Advokimit dhe Ndikimit në Politikbërje.

Co-PLAN CISP VIS COSV Suedi Sverige

Green-AL

# PËRSHTATJA E BUJQËSISË, SI SFIDË PËRBALLË NDRYSHIMEVE KLIMATIKE

## FORUMI I MENDIMIT TË LIRË





**Ku është zbatuar projekti**
Shqipëri

**Kohëzgjatja**
13 muaj

**Buxhet total**
58,452 Euro

---

## OBJEKTIVAT E PROJEKTIT

**Objektivat e Përgjithshëm**

Informimi i fermerëve dhe specialistëve të bujqësisë për efektet e ndryshimit të klimës në bujqësi. Sensibilizimi i qeverisë dhe nxitja e masave ligjore për të ngritur institucione që prodhojnë politika orientuese dhe kërkim shkencor, në shërbim të përshtatjes së këtij sektori me kushtet e reja të klimës.

**Objektivat Specifik**

1. Të trajnojë specialistët e bujqësisë, për ti aftësuar në këshillimin dhe orientimin e fermerëve në punën e përditshme dhe investimet afatgjata në bujqësi, në referim të kushteve të reja klimatike.
2. Rekomandime për qeverinë dhe lobim për krijimin e një institucioni studimor, që do të prodhojë politika orientuese dhe kërkime shkencore.
3. Rritja e kapaciteteve të OSHC-ve lokale të këtij rrjeti mbi çështjet e mjedisit dhe ndryshimeve klimatike.

**Grupet e interesit**

Fermerët, shoqatat e fermerëve, specialistët e bujqësisë.

**Përfituesit përfundimtarë**

Fermerët dhe gjithë shoqëria shqiptare.

## REZULTATET E PRITSHME

R1. Fermerët do të informohen mbi pasojat e drejtëpërdrejta që shkaktojnë ndryshimet e klimës në sektorin e bujqësisë.

R2. Specialistët e bujqësisë, të angazhuar në shërbim të fermerëve, do të aftësohen për t'i konsultuar ata jo vetëm për çështje teknike, por edhe për metodat e reja që diktojnë në bujqësi ndryshimet e klimës.

R3. Dokument rekomandimesh për qeverinë dhe lobim për krijimin e një mekanizmi të përhershëm informimi, si dhe ngritjen e një institucioni shkencor, që të prodhojë studime, politika orientimi si dhe të zhvillojë kërkime në shërbim të përshtatjes së bujqësisë me kushtet e reja të klimës.

R4. Krijimi, trajnimi dhe konsolidimi i një rrjeti kombëtar OSHC-shë, për të vepruar dhe adresuar në vazhdimësi çështjet e mjedisit dhe specifikisht ndryshimet klimatike.

## AKTIVITETET KRYESORE

- Organizimi i 18 takimeve informuese me fermerë, shoqatat e tyre dhe zyrtarë të pushtetit vendor, në 6 qarqe të vendit.

- Prodhimi i dy dokumentarëve televizivë, "Bujqësia në epokën e re", dhe "Fundi i parajsës së ujit", për të treguar pasojat e ndryshimit të klimës në bujqësi dhe mjedis.

- Zhvillimi i 4 sesioneve trajnimi me specialistë të bujqësisë së Agjencisë Rajonale të Ekstensionit Bujqësor(AERB). Trajnimet do të zhvillohen në 4 qarqe ku ndodhen zyrat rajonale të AREB-ve.

- Hartimi i një dokumenti mbi situatën dhe nevojën urgjente të ngritjes së një institucioni kërkimor, për përshtatjen e bujqësisë me kushtet e reja të klimës. Do të propozohet dhe lobohet pranë qeverisë për realizimin e tij,

- Organizatat përbërëse të rrjetit do të mbështeten të rrisin kapacitetet dhe do të ndjekin konferencat trajnuese të projektit Green-AL. Në përfundim, do të analizohet progresi profesional dhe do të zyrtarizohet bashkëveprimi në vazhdimësi si rrjet për çështjet e klimës

## MBI GREEN-AL

Projekti "Fuqizimi i Organizatave të Shoqërisë Civile për Mbrojtjen e Mjedisit në Shqipëri" zbatohet nga Co-PLAN, Instituti për Zhvillimin e Habitatit; në bashkëpunim me CISP, Comitato Internazionale per lo Sviluppo dei popoli; VIS, Volontariato Internazionale per lo Sviluppo; COSV, Coordinamento delle Organizzazioni per il Servizio Volontario me mbështetjen financiare të Agjencisë Ndërkombëtare Suedeze për Bashkëpunim dhe Zhvillim (SIDA).

Projekti synon të kontribuojë në përmirësimin dhe faktorizimin e OSHC-ve mjedisore, për të adresuar në mënyrë efektive sfidat mjedisore në vend. Fokus të veçantë, projekti i jep forcimit të kapaciteteve të OSHC-ve dhe krijimin e mundësive të reja për bashkëpunim ndërmjet tyre, komunitetit, autoriteteve publike dhe sektorit privat.

Projekti Green-AL ka ofruar ndihmë financiare në formën e granteve për të mbështetur OSHC-të mjedisore në vend për të ngritur dhe adresuar problematika mjedisore por edhe për tu rrjetëzuar e advokuar në mënyrë të unifikuar për politika mjedisore më të mira. Skema e granteve është organizuar në 3 paketa: 1) Grantet e Iniciativës; 2) Grantet e Partneritetit; 3) Grantet e Rrjetëzimit, Advokimit dhe Ndikimit në Politikbërje.

# TIRANA JUNGLE CITY

## EDS FOUNDATION



**Ku është zbatuar projekti**
Bashkia Tiranë

**Kohëzgjatja**
**6** muaj

**Buxheti total**
10,850 Euro

---

## OBJEKTIVAT E PROJEKTIT

**Objektivat e Projektit**

1. Integrimi i hapësirave të gjelbërta interaktive në mjedisin e shkollës 9-vjecare.
2. Edukimi i nxënësve mbi agrokulturën përmes veprimtarive të kopshtarisë duke nisur që nga klasa e parë.
3. Krijimi i hapësirave të gjebërta çlodhëse për të gjithë ciklin 9-vjecar.
4. Promovimi i konceptit të punës në komunitet duke organizuar punën në grupe 2-she.
5. Qasja e nxënësve kundrejt natyrës dhe benefiteve të saj.
6. Ndërgjegjësimi i ciklit 9-vjecar për impaktin pozitiv që ka tek njeriu kujdesi për bimët duke i lënë përgjegjësi atyre vetë për mbarëvajtjen e një procesi kopshtarie.
7. Promovimi i projektit në nivel komuniteti e më gjerë.

**Grupi i interesit**
Shkollat 9-vjeçare në Bashkinë e Tiranës.

**Përfituesit përfundimtarë**
Shkollat 9-vjeçare në Bashkinë e Tiranës dhe komuniteti.

## REZULTATET E PRITSHME

R1. Vazhdimësia e trajnimit dhe edukimit të nxënësve pas projektit nga vetë shkolla.

R2. Mirëmbajtja e këtyre hapësirave pas përfundimit të projektit.

R3. Shtrirja e kësaj metodologjie në të gjithë shkollat e Tiranës e më tej në të gjithë rajonin.

R4. Sensibilizimi jo vetëm i shkollave por i cdo komuniteti, qyteti e çdo institucioni që ato përfaqësojnë, në ngritjen e këtyre hapësirave të gjelbërta kudo.



## AKTIVITETET KRYESORE

1. Prezantimin e kësaj iniciative me anë të një aktiviteti hapës për prezantimin e nismës dhe objektivat.
2. Seminare apo takime me grupe të ndryshme interesi apo Shoqëri Civile Mjedisore dhe ambientale.
3. Aktivitete interaktive për fëmijët e shkollës në lidhje me problematikën e ngritur si dhe qëllimin e projektit.
4. Promovimin e këtij projekti në media apo gazeta lokale apo kombëtare
5. Event dhe aktivitet zbavitës për fëmijët si shenjë falenderimi për bashkepunimin në mbyllje të projektit si dhe paraqitjen e kësaj hapësire të gjelbërt si shembull për tu ndjekur.

## MBI GREEN-AL

Projekti "Fuqizimi i Organizatave të Shoqërisë Civile për Mbrojtjen e Mjedisit në Shqipëri" zbatohet nga Co-PLAN, Instituti për Zhvillimin e Habitatit; në bashkëpunim me CISP, Comitato Internazionale per lo Sviluppo dei popoli; VIS, Volontariato Internazionale per lo Sviluppo; COSV, Coordinamento delle Organizzazioni per il Servizio Volontario me mbështetjen financiare të Agjencisë Ndërkombëtare Suedeze për Bashkëpunim dhe Zhvillim (SIDA).

Projekti synon të kontribuojë në përmirësimin dhe faktorizimin e OSHC-ve mjedisore, për të adresuar në mënyrë efektive sfidat mjedisore në vend. Fokus të veçantë, projekti i jep forcimit të kapaciteteve të OSHC-ve dhe krijimin e mundësive të reja për bashkëpunim ndërmjet tyre, komunitetit, autoriteteve publike dhe sektorit privat.

Projekti Green-AL ka ofruar ndihmë financiare në formën e granteve për të mbështetur OSHC-të mjedisore në vend për të ngritur dhe adresuar problematika mjedisore por edhe për tu rrjetëzuar e advokuar në mënyrë të unifikuar për politika mjedisore më të mira. Skema e granteve është organizuar në 3 paketa: 1) Grantet e Iniciativës; 2) Grantet e Partneritetit; 3) Grantet e Rrjetëzimit, Advokimit dhe Ndikimit në Politikbërje.

Green-AL

# MONITORIMI I PERFORMANCËS MJEDISORE NËPËRMJET DIXHITALIZIMIT TË TË DHËNAVE



## INSTITUTI PËR MENAXHIMIN E MJEDISIT DHE TERRITORIT

**Ku është zbatuar projekti**
Bashkia Kavajë, Rrogozhinë dhe Divjakë

**Kohëzgjatja**
15 muaj

**Buxheti total**
40,000 Euro



---

## OBJEKTIVAT E PROJEKTIT

**Objektivi i Përgjithshëm**

Vlerësimi i nivelit të emetimeve të gazeve serrë për tre bashkitë respektive nëpërmjet mjeteve inovative dhe adresimi i masave për qytete me karbon të ulët.

**Objektiviat Specifik**

1. Vlerësimi dhe monitorimi i emetimeve të gazeve me efekt serrë sipas një metodologjie të përcaktuar, në Bashkitë Roskovec, Divjakë, Kavajë nëpërmjet zhvillimit të një softi.
2. Rritja e kapaciteteve të institucioneve lokale mbi mbledhjen dhe analizmin e të dhënave dhe përpunimin e tyre.
3. Hartimi i planeve lokale të veprimit për ndryshimet klimatike për secilën nga bashkitë e përcaktuara.
4. Zhvillimi i projekteve pilot për sektorët me ndikim më të lartë mbi emetimin e gazeve me efekt serrë për arritjen e objektivave të vendosur.

**Grupi i interesit**

Organizata të Shoqërisë Civile

**Përfituesit përfundimtarë**

Institucionet publike (bashkitë e përcaktuara), Bizneset, Komunitetet lokale.

## REZULTATET E PRITSHME

R1. Inventari i gazeve serrë është prodhuar dhe ndërtuar sipas metodologjisë së përcaktuar:

- Ndërtimi i soft-it i zhvilluar për vlerësimin dhe monitorimin e emetimeve të gazeve me efekt serrë për 3 Bashkitë e përcaktuara.
- 1 Manual përdorimi i soft-it i përgatitur dhe dorëzuar përfaqësuesve të bashkisë të përfshirë në projekt.
- 1 pyetësor i hartuar, i njëjtë për të 3 bashkitë për grumbullimin e të dhënave të nevojshme për monitorimin e emetimeve të gazeve me efekt serrë.
- 9 përfaqësues të bashkive (3 në cdo bashki) të trajnuar mbi mbledhjen, analizimin dhe përpunimin e të dhënave në softin e zhvilluar.

R2: 3 plane lokale veprimi për ndryshimet klimatike (1 për cdo bashki) të hartuar për reduktimin e emetimeve të gazeve me efekt serrë.

R3: 3 projekte pilot (1 për cdo bashki) të propozuar për arritjen e objektivave të vendosur për zvogëlimin e emetimeve të gazeve me efekt serrë

## AKTIVITETET KRYESORE

1. Inventarizimi i gazeve me efekt serrë në 3 bashkitë e përcaktuara
   1.1 Ndërtimi dhe zhvillimi i soft-it për monitorimin e emetimeve të gazeve me efekt serrë;
   1.2 Hartimi i pyetësorit për mbledhjen e të dhënave sipas metodologjisë së përcaktuar;
   1.3 Trajnimi i përfaqësuesve të bashkive dhe ekspertëve të jashtëm lokal;
   1.4 Grumbullimi dhe analizimi i të dhënave për secilën bashki.
2. Hartimi i planeve lokale të veprimit për ndryshimet klimatike për reduktimin e emetimeve të gazeve me efekt serrë në tre bashkitë respektive.
3. Propozimi i projekteve pilot për arritjen e objektivave të përcaktuar për secilën bashki:
   3.1 Hartimi i 3 projekteve pilote (1 në cdo bashki) për arritjen e objektivave të përcaktuar;
   3.2 Realizimi i takimeve me komunitetet lokale, bizneset dhe përfaqësuesit e bashkive për prezantimin e projekteve pilote.

## MBI GREEN-AL

Projekti "Fuqizimi i Organizatave të Shoqërisë Civile për Mbrojtjen e Mjedisit në Shqipëri" zbatohet nga Co-PLAN, Instituti për Zhvillimin e Habitatit; në bashkëpunim me CISP, Comitato Internazionale per lo Sviluppo dei popoli; VIS, Volontariato Internazionale per lo Sviluppo; COSV, Coordinamento delle Organizzazioni per il Servizio Volontario me mbështetjen financiare të Agjencisë Ndërkombëtare Suedeze për Bashkëpunim dhe Zhvillim (SIDA).

Projekti synon të kontribuojë në përmirësimin dhe faktorizimin e OSHC-ve mjedisore, për të adresuar në mënyrë efektive sfidat mjedisore në vend. Fokus të veçantë, projekti i jep forcimit të kapaciteteve të OSHC-ve dhe krijimin e mundësive të reja për bashkëpunim ndërmjet tyre, komunitetit, autoriteteve publike dhe sektorit privat.

Projekti Green-AL ka ofruar ndihmë financiare në formën e granteve për të mbështetur OSHC-të mjedisore në vend për të ngritur dhe adresuar problematika mjedisore por edhe për tu rrjetëzuar e advokuar në mënyrë të unifikuar për politika mjedisore më të mira. Skema e granteve është organizuar në 3 paketa: 1) Grantet e Iniciativës; 2) Grantet e Partneritetit; 3) Grantet e Rrjetëzimit, Advokimit dhe Ndikimit në Politikbërje.

Co-PLAN CISP VIS COSV Suedi Sverige

# TË RINJTË MIQËSOR ME MJEDISIN

## SHOQATA ALPIN



**Ku është zbatuar projekti** Bashkia Tropojë

**Kohëzgjatja**

**8** muaj

**Buxheti total**

9,999 Euro



---

## OBJEKTIVAT E PROJEKTIT

**Objektivi i përgjithshëm**

Zhvillimi i të kuptuarit gjithëpërfshirës mbi mbrojtjen e natyrës permes pjesëmarrjes së komunitetit, duke siguruar përdorimin e qëndrueshëm të burimeve natyrore dhe mirëqënie sociale.

**Objektivat specifik**

1. Ofrimi i edukimit mjedisor per zhvillimin e ndjenjes se pergjegjesise per mbrojtjen e biodiversitetit dhe llojeve endemike tek brezat e rinj.

2. Krijimi i drejtuesve per prezantimin e SDG-ve te KB ne vec;anti dhe mbrojtjen e mjedisit ne pergjithesi, promovimi i praktikave te mira mjedisore duke ndikuar ne nivelin e mireqenies per banoret e zonave rurale.

**Grupet e interesit**

Nxënësit e shkollave: "Ali Iber Neza dhe "Besëlidhja e Malësisë", të rinjtë e qytetit, Eco grupet rinore, strukturat arsimore, komuniteti lokal.

**Përfituesit përfundimtarë**

Të rinjtë e zonës në studim, komuniteti i zonës, qeverisja qëndrore dhe lokale, OJF mjedisore në Tropojë, ARZM Tropojë.

## REZULTATET E PRITSHME

1. Ndërgjegjësimi dhe ndjenja e përgjegjësisë midis të rinjve dhe komunitetit për mbrojtjen e biodiversitetit dhe llojet endemike.

2. Njohuritë mbi praktikat e mira mjedisore nga të rinjtë dhe promovimi i vlerave ekologjike dhe mjedisore për një zhvillimin të qëndrueshëm.

## ATIVITETET KRYESORE

- Krijimi i ekipit operacional të Projektit.
- Sesione informuese me nxënësit e dy shkollave dhe institucionet lokale.
- Zhvillimi i pyetësorëve për të marrë informacionet e nevojshme mbi nevojat në procesin e Vlerësimit të Nevojave.
- Trajnime në dy shkolla me grupet e të rinjve të përzgjedhur.
- Trajnim 3 ditor me Lehtësues dhe trajnuesit në dy shkollat, edukimi interaktiv në kuadër të praktikave studentore.
- Trajnimi për çështjet lokale mjedisore në tematikat:
  - rolin e femrave në ekonomine qarkulluese;
  - planifikimi mjedisor nëpërmjet shërbimeve të ekosistemit;
  - manaxhimi i mbetjeve;
- Murale me nxënesit në dy shkolla.
- Shkëmbim eksperiencash me organizaten mjedisore nga Peja.
- Dita e tokës "Të jemi miqësorv me mjedisin".
- Lumi i Gashit pjesë e Brezit të Gjelbër, ditë feste në qytetin e Tropojës.
- Turizmi prioritet për të rinjtë.
- Pjesëmarrje në konferencën vjetore të organizuar në kuadër të projektit Green-AL "Fuqizimi i organizatave mjedisore të shoqërisë civile për mbrojtjen e mjedisit në Shqipëri".

## MBI GREEN-AL

Projekti "Fuqizimi i Organizatave të Shoqërisë Civile për Mbrojtjen e Mjedisit në Shqipëri" zbatohet nga Co-PLAN, Instituti për Zhvillimin e Habitatit; në bashkëpunim me CISP, Comitato Internazionale per lo Sviluppo dei popoli; VIS, Volontariato Internazionale per lo Sviluppo; COSV, Coordinamento delle Organizzazioni per il Servizio Volontario me mbështetjen financiare të Agjencisë Ndërkombëtare Suedeze për Bashkëpunim dhe Zhvillim (SIDA).

Projekti synon të kontribuojë në përmirësimin dhe faktorizimin e OSHC-ve mjedisore, për të adresuar në mënyrë efektive sfidat mjedisore në vend. Fokus të veçantë, projekti i jep forcimit të kapaciteteve të OSHC-ve dhe krijimin e mundësive të reja për bashkëpunim ndërmjet tyre, komunitetit, autoriteteve publike dhe sektorit privat.

Projekti Green-AL ka ofruar ndihmë financiare në formën e granteve për të mbështetur OSHC-të mjedisore në vend për të ngritur dhe adresuar problematika mjedisore por edhe për tu rrjetëzuar e advokuar në mënyrë të unifikuar për politika mjedisore më të mira. Skema e granteve është organizuar në 3 paketa: 1) Grantet e Iniciativës; 2) Grantet e Partneritetit; 3) Grantet e Rrjetëzimit, Advokimit dhe Ndikimit në Politikbërje.

# ANGAZHIM KOMUNITAR PËR MBROJTJEN E BURIMEVE UJORE TË FSHATIT MADHESH, BASHKIA MAT



## ORGANIZATA "MIQËSIA" ULËZ

**Ku është zbatuar projekti**
Fshati Madhesh, Njësia Administrative Ulëz, Bashkia Mat

**Kohëzgjatja**
9 muaj

**Buxheti total**
9,855 Euro



---

## OBJEKTIVAT E PROJEKTIT

**Objektivi i Përgjithshëm**

Përmirësimi i cilësisë së jetës, përmes mbrojtjes se burimeve ujore, vlerësimit të parametrave mjedisore dhe vlerave të biodiversitetit (flora, fauna, uji, toka) për banorët e fshatit Madhesh.

**Objektivat Specifik**

Vlerësimi dhe mbrojtja e burimeve ujore si e vetmja mundësi për sigurimin e uijt vaditës për komunitetin e fshatit Madhesh.

Informimi i komunitetit dhe autoriteteve në nivel vendor e qëndror lidhur me impaktet negative në zonë, që shkaktohen nga ndërtimi i HEC-it Madhesh. Vlerësim i gjendjes ekonomiko-sociale dhe mjedisore që shkaktohen nga ndërtimi i HEC-it për banorët e zonës dhe kryesisht në fshatin Madhesh.

**Grupi i interesit**

Komuniteti i fshatit Madhesh.

**Përfituesit përfundimtareë**

Njësia Administrative Ulëz, Bashkia Mat, vizitorët e zonës, bizneset dhe aktorët lokal të zhvillimit të turizmit në zonë. Parku Natyror Rajonal Ulëz, OJF-të e zonës.

## REZULTATET E PRITSHME

- Vlerësim I ligjshmërise së dokumentacionit të kompanisë koncesionare për ndërtimin e HEC-it Madhesh.
- Vlerësim i raportit të VNM-se nga kompania zhvilluese e HEC-it.
- Analizë e vlerësimit të biodiversitetit, florës dhe faunës së zonës.
- Adresimi i çështjes pranë gjykatës shqiptare së bashku me shkresat dhe aktet e ekspertëve përkatës ligjor, mbledhje firmash, përgatitje peticionesh.
- Ndërgjegjësim lidhur me pasojat e mundshme negative sociale, ekonomike mjedisore për banorët e fshatit Madhesh.

## AKTIVITETET KRYESORE

- Angazhim i ekspertit ligjor per vleresimin e ligjshmerise se dokumentacionit te kompanise koncensionare per ndertimin e HEC-it ne Madhesh.
- Angazhim ekspertit mjedisor per vleresimin e raportit te VNM-se si dhe vleresimin e impaktit mbi floren dhe faunen e zones.
- Angazhim i komunitetit per adresimin e <;:eshtjes prane gjykatave shqiptare (mbledhje firmash, pergaditje peticionesh/shkresash dhe ankesash permes ekspertit ligjor).
- Organizimi i degjesave publike me komunitetin, me qellim ndergjegjesimin e tyre, njohjen me bazen ligjore, shkeljet nga kompania, njohje me te drejten e perdorimit te burimeve ujore.
- Pergatitje materialesh informative (banera, postera, parulla, flete-palosje).

## MBI GREEN-AL

Projekti "Fuqizimi i Organizatave të Shoqërisë Civile për Mbrojtjen e Mjedisit në Shqipëri" zbatohet nga Co-PLAN, Instituti për Zhvillimin e Habitatit; në bashkëpunim me CISP, Comitato Internazionale per lo Sviluppo dei popoli; VIS, Volontariato Internazionale per lo Sviluppo; COSV, Coordinamento delle Organizzazioni per il Servizio Volontario me mbështetjen financiare të Agjencisë Ndërkombëtare Suedeze për Bashkëpunim dhe Zhvillim (SIDA).

Projekti synon të kontribuojë në përmirësimin dhe faktorizimin e OSHC-ve mjedisore, për të adresuar në mënyrë efektive sfidat mjedisore në vend. Fokus të veçantë, projekti i jep forcimit të kapaciteteve të OSHC-ve dhe krijimin e mundësive të reja për bashkëpunim ndërmjet tyre, komunitetit, autoriteteve publike dhe sektorit privat.

Projekti Green-AL ka ofruar ndihmë financiare në formën e granteve për të mbështetur OSHC-të mjedisore në vend për të ngritur dhe adresuar problematika mjedisore por edhe për tu rrjetëzuar e advokuar në mënyrë të unifikuar për politika mjedisore më të mira. Skema e granteve është organizuar në 3 paketa: 1) Grantet e Iniciativës; 2) Grantet e Partneritetit; 3) Grantet e Rrjetëzimit, Advokimit dhe Ndikimit në Politikbërje.

LËVIZJA RINORE QYTETI IM EKOLOGJIK

**FORUMI SHQIPTAR LIQENI I SHKODRËS**



**Ku është zbatuar projekti**
**Bashkitë Shkodër dhe Lezhë**

**Kohëzgjatja**
**15 muaj**

**Buxheti total**
**28,182.00 Euro**

---

## OBJEKTIVAT E PROJEKTIT

| | |
|---|---|
| Objektivi i Përgjithshëm | Rritja e përgjegjëshmërisë mjedisore për të garantuar cilësinë e jetës humane dhe biologjike në rajonin Veri-Perëndimor. |
| Objektivi (at) Specifik | • Nxitja e kreativitetit dhe e angazhimit të të rinjve për mbrojtjen dhe rehabilitimin e mjediseve natyrore;<br>• Vlerësimi i potencialeve dhe sfidave të vizionit Shkodra Qytet Ekologjik; Promovimi i praktikave të qëndrueshme për një mjedis të shëndetshëm për fëmijët tanë. |
| **Grupet e interesit** | • Të rinjtë dhe të rejat e 4 gjimnazeve "Oso Kuka", "28 Nëntori", "Jordan Misja" në Shkodër & "Hydajet Lezha" në Lezhë;<br>• Organizatat e Shoqërisë Civile; Mësues, ekspertë, akademikë;<br>• Administrata e Zonave të Mbrojtura;<br>• Qytetarët e rajonit Veri-Perëndimor (burra dhe gra). |
| **Përfituesit përfundimtarë** | • Të rinjtë dhe të rejat target në projekt;<br>• Bashkia Shkodër;<br>• Administrata e Zonave të Mbrojtura; Qytetarët. |

## REZULTATET E PRITSHME

R1: Palët e interesit janë informuar/gjithëpërfshirja është garantuar;

R2: Raport Studimi: "Vlerësimi i Nevojave dhe Standardet Mjedisore për një Qytet Ekologjik - Bashkia Shkodër";

R3: Panairi i Ideve - "Qyteti im Ekologjik";

R4: Krijimi i parcelave të gjelbra të emërtuara.



## AKTIVITETET KRYESORE

- Takim informues – prezantues në nivel rajonal me palët e interesit;
- Përgatitja e pyetësorit dhe metodologjisë së studimit nga grupi i ekspertëve;
- Anketim qytetar & Analizë dhe kërkim shkencor i studimit;
- Përgatitja e draft raportit të studimit dhe konsultimi me anëtarët e Këshillit Bashkiak, donatorin, pedagogë të Universitetit;
- Mbajtja e konsultimit publik me palët e interesit, reflektimi i ndryshimeve dhe sugjerimeve në dokument - përgatitja e draftit final;
- Hartimi, publikimi dhe shpërndarja e raportit;
- Takime të grupit të punës për zbatimin e projektit me drejtoritë respektive të shkollave target;
- Përzgjedhja dhe nominimi i mësuesve koordinatorë; Përgatitja dhe shpërndarja e udhëzuesit në 4 gjimnazet konkuruese;
- Përzgjedhja dhe kontraktimi i mentorëve që do të trajnojnë/ stërvitin grupet e punës të të rinjve të angazhuar në garën e ideve " Qyteti im Ekologjik"; Paisja e grupeve të punës me materiale për krijimin e modeleve/maketeve e koncepteve të një qyteti ekologjik;
- Punë përgatitore e të rinjve për konkursin "Qyteti im Ekologjik";
- Hapja e panairit - shpallja e fituesit - prezantimi i çmimit fitues në Keshillin Bashkiak Shkodër;
- Takim i grupit të punës me AdZM-të në Shkodër dhe Lezhë;
- Përcaktimi i sipërfaqeve parcelore për secilin gjimnaz target - këshillimi dhe përcaktimi i habitateve të rekomanduara për mbjellje nga ekspertët e Klubit Ekologjik;
- Përzgjedhja dhe blerja e fidanëve - dezinjimi, përgatitja dhe vendosja e 4 tabelave për parcelat e mbjella nga secili gjimnaz & Mbjellja e fidanëve.

## MBI GREEN-AL

Projekti "Fuqizimi i Organizatave të Shoqërisë Civile për Mbrojtjen e Mjedisit në Shqipëri" zbatohet nga Co-PLAN, Instituti për Zhvillimin e Habitatit; në bashkëpunim me CISP, Comitato Internazionale per lo Sviluppo dei popoli; VIS, Volontariato Internazionale per lo Sviluppo; COSV, Coordinamento delle Organizzazioni per il Servizio Volontario me mbështetjen financiare të Agjencisë Ndërkombëtare Suedeze për Bashkëpunim dhe Zhvillim (SIDA).

Projekti synon të kontribuojë në përmirësimin dhe faktorizimin e OSHC-ve mjedisore, për të adresuar në mënyrë efektive sfidat mjedisore në vend. Fokus të veçantë, projekti i jep forcimit të kapaciteteve të OSHC-ve dhe krijimin e mundësive të reja për bashkëpunim ndërmjet tyre, komunitetit, autoriteteve publike dhe sektorit privat.

Projekti Green-AL ka ofruar ndihmë financiare në formën e granteve për të mbështetur OSHC-të mjedisore në vend për të ngritur dhe adresuar problematika mjedisore por edhe për tu rrjetëzuar e advokuar në mënyrë të unifikuar për politika mjedisore më të mira. Skema e granteve është organizuar në 3 paketa: 1) Grantet e Iniciativës; 2) Grantet e Partneritetit; 3) Grantet e Rrjetëzimit, Advokimit dhe Ndikimit në Politikbërje.

# PËRMIRËSIMI I IMAZHIT TË VENDIT PËRMES AKTIVITETEVE MJEDISORE NË BAJZË - HANI I HOTIT (MALËSIA E MADHE)



## SHOQATA BLINI

**Ku është zbatuar projekti**
Bashkia Malësi e Madhe

**Kohëzgjatja**
9 muaj

**Buxheti total**
9,820.00 Euro

---

## OBJEKTIVAT E PROJEKTIT

| | |
|---|---|
| **Objektivi i Përgjithshëm** | Përmiresimi i imazhit dhe atraksionit të vendit nëpërmjet aktiviteteve mjedisore që synojne krijimin e një mjedisi të pastër dhe më të shëndetshëm për vizitorët dhe ekosistemet natyrore. |
| **Objektivat Specifik** | • Rritje e nivelit të edukimit mjedisor përmes pjesëmarrjes në aktivitete mjedisore;<br>• Përmirësim i mjedisit në zonën hyrëse të Hanit të Hotit, si dhe bregun e liqenit të Shkodrës;<br>• Përmirësim i ofertës turistike në zonë, si rezultat i përmirësimit të gjendjes së mjedisit. |
| **Grupet e Interesit** | • Nxënësit e shkollës 9-vjeçare "Prek Gjoni" në Bajzë,<br>• Komuniteti në Njësinë Administrative Kastrat, Bashkia Malësi e Madhe,<br>• Aktivistët dhe organizatat e mjedisit, Administrata Rajonale e Zonave të Mbrojtura Qarku Shkodër. |
| **Përfituesit përfundimtarë** | Komuniteti i zonës, Bashkia Malësi e Madhe, bizneset, operatorët turistikë, turistët. |

## REZULTATET E PRITSHME

R1. Krijimi i nje mjedisi te paster ne piken e kalimit kufitar

R2: Edukimi mjedisor permes aktiviteteve ne Malesine e madhe

R3: Rrjetezim i shkollave dhe organizatave mjedisore per ceshtjet mjedisore



## AKTIVITETET KRYESORE

- Edukim mjedisor duke punuar në terren për heqjen e mbeturinave nga pika e kalimit kufitar, liqeni i Shkodrës dhe aksi rrugor Hani i Hotit-Bajzë;
- Markimi i shtigjeve nga rruga nacionale Hani i Hotit-Bajzë për në monumentet natyrore;
- Vendosja e koshave të mbetjeve në: pikën e kalimit kufitar, shkollë, monumentet e natyrës;
- Rrjetëzimi lokal me nxënës, mësues, organizata mjedisore duke krijuar një aleancë mjedisore lokale;
- Organizim aktivitetesh në nivel programi.

## MBI GREEN-AL

Projekti "Fuqizimi i Organizatave të Shoqërisë Civile për Mbrojtjen e Mjedisit në Shqipëri" zbatohet nga Co-PLAN, Instituti për Zhvillimin e Habitatit; në bashkëpunim me CISP, Comitato Internazionale per lo Sviluppo dei popoli; VIS, Volontariato Internazionale per lo Sviluppo; COSV, Coordinamento delle Organizzazioni per il Servizio Volontario me mbështetjen financiare të Agjencisë Ndërkombëtare Suedeze për Bashkëpunim dhe Zhvillim (SIDA).

Projekti synon të kontribuojë në përmirësimin dhe faktorizimin e OSHC-ve mjedisore, për të adresuar në mënyrë efektive sfidat mjedisore në vend. Fokus të veçantë, projekti i jep forcimit të kapaciteteve të OSHC-ve dhe krijimin e mundësive të reja për bashkëpunim ndërmjet tyre, komunitetit, autoriteteve publike dhe sektorit privat.

Projekti Green-AL ka ofruar ndihmë financiare në formën e granteve për të mbështetur OSHC-të mjedisore në vend për të ngritur dhe adresuar problematika mjedisore por edhe për tu rrjetëzuar e advokuar në mënyrë të unifikuar për politika mjedisore më të mira. Skema e granteve është organizuar në 3 paketa: 1) Grantet e Iniciativës; 2) Grantet e Partneritetit; 3) Grantet e Rrjetëzimit, Advokimit dhe Ndikimit në Politikbërje.

Suedi
Sverige

# RRJETI PËR FUQIZIMIN DHE ANGAZHIMIN E OSHC-VE PËR EFICIENCËN E ENERGJISË NË SHQIPËRINË E JUGUT

## INSTITUTI PËR NDRYSHIM DHE LIDERSHIP NE SHQIPERI



**Ku është zbatuar projekti**
Rajoni i Jugut (Bashkitë Vlorë, Sarandë, Gjirokastër)

**Kohëzgjatja**
18 muaj

**Buxheti total**
30,733 Euro

---

## OBJEKTIVAT E PROJEKTIT

**Objektivi i Pergjithshem**

T'i mundësojë sektorit të shoqërisë civile në Shqipëri të përmbushë rolin e tij në mjedisin demokratik duke vepruar si bashkëbisedues të pavarur duke monitoruar institucionet publike, duke rritur llogaridhënien dhe transparencën në zhvillimin e politikave dhe proceset e vendimmarrjes, në fushën e ruajtjes dhe promovimit të efiçencës së energjisë (EE) dhe energjisë së rinovueshme (ER) në shërbimet publike.

**Objektivat Specifik**

OS 1: Rritja e incentives për të përmirësuar pjesëmarrjen e OSHC-ve në politikëbërje dhe zbatim të politikave, advokimin dhe aktivitete përmes krijimit të Rrjetit Rajonal të Jugut të OSHC-ve për promovimin e zbatimit të masave EE dhe ER në shërbimet publike;

OS 2: Përmirsëimi i aftësive dhe ndarjes së informacionit të OSHC-ve për monitorimin e politikave, advokimin dhe fushatave në lidhje me zbatimin e Planit Kombëtar për Energjinë dhe Klimën 2020-2030 në planet vendore;

OS 3: Ngritja e dialogut publik, për të rritur ndërgjegjësimin për rëndësinë e efiçencës së energjise dhe për të kërkuar mënyra efektive për të promovuar EE dhe ER në shërbime publike.

**Grupet e interesit**

Projekti përfaqëson interesin e OSHC- ve, dy bashkive dhe një Universiteti që janë të interesuar për të mësuar më shumë, angazhuar në aktivitete advokuese, hulumtuese dhe monitoruese mbi zbatimin e masave EE dhe ER në nivel lokal dhe angazhimin e palëve në këtë proces.

**Perfituesit perfundimtare**

Autoritetet publike qëndrore - të informuar mbi njohuritë, sfidat, kapacitetet dhe rekomandimet e ardhura nga niveli lokal; Popullsia e përgjithshme Rritja e ndërgjegjësimit të qytetarëve për çështjet e zhvillimit të qëndrueshëm dhe opsionet e zhvillimit të qëndrueshëm në Shqipëri.

## REZULTATET E PRITSHME

R.1: Aktorët lokalë janë informuar për rolin e OSHC-ve në politikëbërje dhe zbatim të politikave, advokimin për promovimin e zbatimit të masave EE dhe ER në shërbimet publike;

R.2: Gjashtë OSHC bëhen nismëtare të krijimit të Rrjetit Rajonal të Jugut të OSHC-ve që promovojnë zbatimin e masave EE dhe ER në shërbimet publike;

R.3: Dokument vlerësimi mbi njohuritë, sfidat, kapacitetet e institucioneve lokale përgjegjëse në nivel lokal, dhe nevojat e njohurite e OSHC-ve dhe qytetareve për të kuptuar zbatimin e planit mbi EE dhe ER në nivel vendor;

R.4: Trajnime në lidhje me energjinë dhe efiçencën e energjisë në shërbimet publike, si dhe ndikimin e saj në ndryshimet klimatike dhe zhvillimin ekonomik lokal;

R.5: OSHC-të në nivel lokal monitorojnë në mënyrë efektive politikat për prokurimin, menaxhimin dhe mirëmbajtjen e shërbimeve publike në 3 bashkite e përzgjedhura kundrejt masave EE dhe ER;

R.6: Dokument përmbledhes i Monitorimit të shërbimeve publike nga OJF-te në bashkitë Vlorë, Sarandë dhe Gjirokastër kundrejt zbatimit të masave EE dhe ER në nivel lokal

R.7: Elaborimi i 3 letrave rekomanduese për masat e EE dhe ER të cilat diskutohen nga këshillat vendore bazuar në draft-raportin e monitorimit, duke ndjekur udhëzimet/ ligjet kombëtare për konsultimin dhe angazhimin e qytetarëve

R 8: Të paktën 180 persona, përfaqësues të OSHC-ve, bashkive, universiteteve/ akademia & studente, media etj., janë përfshirë në diskutim në zbatim të masave të secilës bashki mbi EE dhe ER në shërbimet publike.

R 9: - Rritja e ndërgjegjësimit të qytetareve në lidhje me çështjet që kanë të bëjnë me energjinë dhe efiçencën e energjisë, si dhe ndikimin e saj në ndryshimet klimatike.

Green-AL

## AKTIVITETET KRYESORE

A1. Formalizimi i partneritetit për rrjetin e OSHC-ve dhe sesione informuese;

A2 Vlerësimi i njohurive dhe kapaciteteve të Bashkive dhe njohurive të qytetarëve mbi efiçencën e energjisë në shërbimet publike, masat dhe detyrimet e bashkive për zbatimin e planit Kombëtar për Energjinë dhe Klimën 2020-2030 në planet vendore;

A3 Ngritja e kapaciteteve dhe njohurive të qytetareve dhe OSHC-ve mbi detyrimet e bashkive për zbatimin e masave të EE në nivel lokal;

A.4 Aktivitete Advokimi dhe informimi për zbatim të masave të planëve vendore mbi EE në shërbimet publike, aktivitete monitoruese, debate/diskutime me Akademinë / Universitete, OSHC - Bashki, Keshilla Vendore

A5. Aktivitete promovuese dhe të vizibilitetit të anëtarëve të rrjetit dhe të projektit.

## MBI GREEN-AL

Projekti "Fuqizimi i Organizatave të Shoqërisë Civile për Mbrojtjen e Mjedisit në Shqipëri" zbatohet nga Co-PLAN, Instituti për Zhvillimin e Habitatit; në bashkëpunim me CISP, Comitato Internazionale per lo Sviluppo dei popoli; VIS, Volontariato Internazionale per lo Sviluppo; COSV, Coordinamento delle Organizzazioni per il Servizio Volontario me mbështetjen financiare të Agjencisë Ndërkombëtare Suedeze për Bashkëpunim dhe Zhvillim (SIDA).

Projekti synon të kontribuojë në përmirësimin dhe faktorizimin e OSHC-ve mjedisore, për të adresuar në mënyrë efektive sfidat mjedisore në vend. Fokus të veçantë, projekti i jep forcimit të kapaciteteve të OSHC-ve dhe krijimin e mundësive të reja për bashkëpunim ndërmjet tyre, komunitetit, autoriteteve publike dhe sektorit privat.

Projekti Green-AL ka ofruar ndihmë financiare në formën e granteve për të mbështetur OSHC-të mjedisore në vend për të ngritur dhe adresuar problematika mjedisore por edhe për tu rrjetëzuar e advokuar në mënyrë të unifikuar për politika mjedisore më të mira. Skema e granteve është organizuar në 3 paketa: 1) Grantet e Iniciativës; 2) Grantet e Partneritetit; 3) Grantet e Rrjetëzimit, Advokimit dhe Ndikimit në Politikbërje.

# "TRANSHUMANCA" SI NJË MODEL I ZHVILLIMIT TË BLEGTORISË SË QËNDRUESHME DHE ZBUTJES SË IMPAKTEVE NEGATIVE TË NDRYSHIMEVE KLIMATIKE

Green-AL





**RUR.AL**

**Ku është zbatuar projekti**
Himarë, Berat, Vlorë

**Kohëzgjatja**
12 muaj

**Buxheti total**
30,946 Euro

---

## OBJEKTIVAT E PROJEKTIT

**Objektivi I Përgjithshëm**

Te kontribuoje ne zbutjen e ndikimeve negative te ndryshimeve klimatike nepermjet zhvillimit te blegtorise se qendrueshme ne territorin e Bashkive Vlore, Skrapar dhe Himare.

**Objektivi Specifik**

Të përmirësojë efiçencën e kullotave që përdoren gjatë "Transhumancës" nëpërmjet rritjes së kapaciteteve teknike/teorike, promovimit dhe politikbërjes efektive.

**Grupet e interesit**

Banorët vendas, aktivitetet ekonomike që veprojnë në fushën blegtorale, komunitetet rurale, institucionet lokale dhe rajonale që menaxhojnë kullotat dhe Zonat e Mbrojtura, etj.

**Perfituesit përfundimtarë**

Familjet praktikuese te transhumances ne rajon dhe ne rang kombetar; blegtore; entet e menaxhimit te fondit kullosor brenda dhe jashte zonave te mbrojtura;qytetaret e qarkut Vlore; sipermarrje blegtorale te udhehequra nga gra e te rinj;

## REZULTATET E PRITSHME

R1: Kapacitetet teknike dhe teorike të komuniteteve blegtorale dhe institucioneve publike, mbi Transhumancën dhe rolin e saj në zbutjen dhe përshtatjen ndaj ndikimeve negative të ndryshimeve klimatike, janë zhvilluar.

R2: Dialogu me organet politikbërëse/ligjzbatuese në rang rajonal, mbi ndryshimet klimatike, është përmirësuar.

R3: Ndërgjegjësimi dhe njohuria e publikut të gjerë mbi problematiken ndaj ndryshimeve klimatike është rritur.

## AKTIVITETET KRYESORE

A.1.1 Realizim i një analize të kontekstit mbi menaxhimin e kullotave dhe blegtorisë duke përfshirë kompenentët socio/ ekonomik, mjedisor dhe kulturor.

A.1.2 Vlerësimi i masave të përshtatshme për të ulur vulnerabilitetin dhe rritjen e aftësive ripërtëritëse ndaj ndryshimeve klimatike.

A.1.3 Implementimi i ndërhyrjeve përmirësuese nëpërmjet rehabilitimit të pjesshëm të 1 lere dhe instalim të 2 paneleve diellore në tre zonat e adresuara.

A.2.1 Zhvillim i 3 workshopeve tematike mbi rolin e transhumancës në funksion të zbutjes së ndikimeve negative të ndyshimeve klimatike

A.2.2 Hartimi dhe prezantimi i nje Policy paper mbi analizën, gjetjet dhe rekomandimet e mundshme në aspektin ligjor, për përshtatjen dhe adresimin e problematikës.

A.3.1 Zhvillimi i një cikli aktivitetesh edukimi me nxënësit/studentët e shkollave lokale.

A.3.2 Realizimi i 3 takimeve informuese me përfituesit dhe stakeholders të projektit.

A.3.3 Realizimin e një video promovuese dhe transmetimi në mediat lokale.

A.3.4 Realizimi një KIT vizibiliteti (Roll-up banner, dosje).

i

## MBI GREEN-AL

Projekti "Fuqizimi i Organizatave të Shoqërisë Civile për Mbrojtjen e Mjedisit në Shqipëri" zbatohet nga Co-PLAN, Instituti për Zhvillimin e Habitatit; në bashkëpunim me CISP, Comitato Internazionale per lo Sviluppo dei popoli; VIS, Volontariato Internazionale per lo Sviluppo; COSV, Coordinamento delle Organizzazioni per il Servizio Volontario me mbështetjen financiare të Agjencisë Ndërkombëtare Suedeze për Bashkëpunim dhe Zhvillim (SIDA).

Projekti synon të kontribuojë në përmirësimin dhe faktorizimin e OSHC-ve mjedisore, për të adresuar në mënyrë efektive sfidat mjedisore në vend. Fokus të veçantë, projekti i jep forcimit të kapaciteteve të OSHC-ve dhe krijimin e mundësive të reja për bashkëpunim ndërmjet tyre, komunitetit, autoriteteve publike dhe sektorit privat.

Projekti Green-AL ka ofruar ndihmë financiare në formën e granteve për të mbështetur OSHC-të mjedisore në vend për të ngritur dhe adresuar problematika mjedisore por edhe për tu rrjetëzuar e advokuar në mënyrë të unifikuar për politika mjedisore më të mira. Skema e granteve është organizuar në 3 paketa: 1) Grantet e Iniciativës; 2) Grantet e Partneritetit; 3) Grantet e Rrjetëzimit, Advokimit dhe Ndikimit në Politikbërje.

## ZHDUKJA E EKOSISTEMEVE NGA AKTIVITETI I MINIERAVË TË GURIT





### VIZIONI I GJELBËR

**Ku është zbatuar projekti**

Bashkia Himarë

**Kohëzgjatja**

12 muaj

**Buxheti total**

10,000 Euro

---

## OBJEKTIVAT E PROJEKTIT

| | |
|---|---|
| **Objektivi i Përgjithshëm** | Frenimi i shkatërrimit të mëtejshem të natyrës dhe rehabilitimi i ekosistemeve të dëmtuara nga aktiviteti i guroreve |
| **Objektivat Specifik** | • Dokumentimi i shkeljeve ligjore të guroreve që operojnë në Bashkinë e Himarës nëpërmjet analizës juridike të kontratave të lidhura, zbatimin e tyre dhe detyrimeve të tjera ligjore.<br>• Vlerësimi i gjurmës mjedisore të këtij aktiviteti dhe hartimi i një pakete rekomandimesh për rehabilitimin e natyrës nëpërmjet ekspertizes mjedisore në terren.<br>• Adresimi i shqetësimit të banorëve për problematikat e shkaktuara nga aktiviteti i guroreve nëpërmjet takimeve të hapura komunitare me pjesëmarrjen e vendimmarrësve dhe ekspertëve të projektit duke i informuar ata me shkallën e dëmtimit të natyrës, bujqësisë, turizmit dhe shkeljet juridike të këtyre aktiviteteve.<br>• Nxitja e sipërmarrjes se guroreve dhe institucioneve përgjegjëse për rehabilitim të zonës së dëmtuar nëpërmjet presionit komunitar dhe realizimit të disa aktiviteteve konkrete si mbjellje pemësh, ndërtim ledhesh, sistemim relievi. |
| **Grupi i interesit** | Banorët rezident të fshatit Vranisht në Bashkinë e Himarës. |
| **Pëfituesit përfundimtarë** | Banorët rezident te fshatit Vranisht ne Bashkine e Himares. |

## REZULTATET E PRITSHME

- Komunitet i aftë të adresojë shqetësimet dhe të kërkojë llogari nga vendimmarrësit.
- Frenim i dëmtimit të natyrës nga aktiviteti i guroreve.
- Rehabilitim i pjesshëm i natyrës së dëmtuar.
- Fillimi i rehabilitimit të plote të natyrës nga kompanitë ą guroreve.
- Jehonë e ngritur për guroret e tjera aktive përgjate lumit të Vlorës.

## AKTIVITETET KRYESORE

A1. Analiza juridike e kontratave të guroreve të targetuara në Bashkinë e Himarës dhe dokumentave lidhur me veprimtarinë e tyre.

A2. Vlerësimi mjedisor i dëmeve të shkaktuara nga aktiviteti i guroreve.

A3. Informimi i banorëve me gjetjet e analizës juridike dhe vlerësimin e dëmeve,

A4. Informimi i banorëve për të drejtat ligjore të informimit, trasparences, llogaridhënies dhe ato që lidhen me shfrytëzimin e pasurive natyrore publike.

A5. Takim i hapur me banorë, administratën e Bashkisë, përfaqësues të institucioneve përgjegjëse, përfaqesues të kompanive të guroreve për adresimin e shqetësimeve të banorëve.

A6. Rehabilitim i pjesshëm i natyrës nga projekti. Aktivitete për rehabilitimin e natyrës me mbjellje pemesh, ndërtim muresh, sistemim relievi.

A7 .Fillimi i rehabilitimit të plotë të natyrës nga koncesionaret.

A8. Prodhimi dhe publikimi i një dokumentari me aktivitetet e projektit për përhapjen e jehonës tek banorët e tjerë të krahinës që po vuajnv në rrethana të ngjashme.

## MBI GREEN-AL

Projekti "Fuqizimi i Organizatave të Shoqërisë Civile për Mbrojtjen e Mjedisit në Shqipëri" zbatohet nga Co-PLAN, Instituti për Zhvillimin e Habitatit; në bashkëpunim me CISP, Comitato Internazionale per lo Sviluppo dei popoli; VIS, Volontariato Internazionale per lo Sviluppo; COSV, Coordinamento delle Organizzazioni per il Servizio Volontario me mbështetjen financiare të Agjencisë Ndërkombëtare Suedeze për Bashkëpunim dhe Zhvillim (SIDA).

Projekti synon të kontribuojë në përmirësimin dhe faktorizimin e OSHC-ve mjedisore, për të adresuar në mënyrë efektive sfidat mjedisore në vend. Fokus të veçantë, projekti i jep forcimit të kapaciteteve të OSHC-ve dhe krijimin e mundësive të reja për bashkëpunim ndërmjet tyre, komunitetit, autoriteteve publike dhe sektorit privat.

Projekti Green-AL ka ofruar ndihmë financiare në formën e granteve për të mbështetur OSHC-të mjedisore në vend për të ngritur dhe adresuar problematika mjedisore por edhe për tu rrjetëzuar e advokuar në mënyrë të unifikuar për politika mjedisore më të mira. Skema e granteve është organizuar në 3 paketa: 1) Grantet e Iniciativës; 2) Grantet e Partneritetit; 3) Grantet e Rrjetëzimit, Advokimit dhe Ndikimit në Politikbërje.

Co-PLAN · CISP · VIS · COSV · Suedi Sverige